

Date 29.12.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Sistem faturimi 48444100-3
- Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të rrjetit të të dhenave 50312300-8
- Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjise së informacionit 50312600-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 144.333.300 (njqind e dyzet e kater milion e treqind e tridhjetë e tre mije e treqind) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mije e katerqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes të Shqipërisë datë 29.12.2023 është 103.88 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën 2.886.666 (dy milion e teteqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH.*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertes në monedhen ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 27.788,47 (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë presje dyzet e shtatë) euro pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$144.333.300 \times 40\% = 57.733.320$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për

deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006" Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 43.299.990 (dyzet e tre milion e dyqind e nentëdhjete e nente mijë e nentëqind e nentëdhjete) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

$144.333.300 \times 30\% = 43.299.990$

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 27001:2013 mbi “Sistemet menaxhimit të sigurisë së informacionit”, e vlefshme (ose **ekuivalente**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin te sigurise se informacionit e cilësisë të shërbimeve që kërkohen dhe lidhen me sistemet e teknologjise se Informacionit. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurise për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.

2.5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkepunimi me prodhuesin e sistemeve me baze te dhenash ORACLE.

- Për sistemin e bazës së të dhënave
- Për sistemet dhe platformat cloud
- Për sistemin Core Audit te bazes se te dhenave

Autorizimi (ose Kontrata e Bashkepunimit) duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Aktualisht shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tirane (UKT) përdor sistemin e faturimit Al-Billing me të drejtë autori dhe bazuar në Ligjit Nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura me to", Neni 48 "Kontrata e së drejtës së autorit", pika 4, ku kompania të ketë autorizim aktiv të vlefshëm me afat trevjeçar ose pesëvjeçar referuar kësaj pike.

Suporti i prodhuesit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

Komponentet e mësipërm, vlerësohen si më të rëndësishmit e projektit të cilat duhet të kenë mbështetjen e prodhuesit.

2.6 Operatori ekonomik ofertues, duhet te kete certifikimet, kualifikimet si me poshte:

- *Infrastructure Cloud;*
- *Sisteme bazash te dhenash Cloud;*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive qe po ofertojne, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Argumentimi: Për këtë, vërejmë se sistemet, kryesore në projekt janë Baza të Dhënash si dhe infrastrukturë Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mësipërme, prodhuesit e programeve informatike të mirënjohur ndërkombëtarë sikurse janë Oracle apo edhe të ngjashëm, kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive të cilat mundet të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kritere teknike; organizative për burimet njerëzore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë e IT si të autorizuar apo jo prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmiresimit apo përditësimit të sistemeve. Nëse shoqëritë nuk kanë certifikime të prodhuesit (për sisteme apo modulet) cdo ndërhyrje në sistem rezikon përfundimin e kushteve të garancisë apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.

Për këtë, certifikimet e mësipërme që kanë lidhje me Modulet apo sistemet që kërkohet të prokurorët jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrje në sistem nga shoqëri të pa-certifikuara mundet të dëmtojë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit mundet të bëhet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë dhe pas saj. Certifikimet e mësipërme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në kontrate do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public.

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zbatime sistemesh ERP
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukture cloud
- 1 (një) punonjës të certifikuar për raportim të tipit BI
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator e bazës së të dhënave
- 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin AL-Billing ose equivalent;
- 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim në web/mobile;

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kontratën e punës

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Implementimi i sistemeve ERP, kërkon njohuri specifike për cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve ERP por edhe me njohjen e paraktikave kontabel dhe operacionale të ndërmarrjeve. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që sistemi do të zbatohet do të mundet të integrohet në mënyrë të sakte me sistemin e brendshëm kontabel të UKT. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.
- b) Punonjësi i certifikuar për sisteme në cloud është njohës i mirë i suportit të këtyre sistemeve. Kërkesa për certifikim, mbështetet në faktin që pjesë e projektit si dhe sistemeve të kërkuara duhet të jenë në modelin hosted. Për këtë, OE duhet të disponojë personel me njohuri në këtë fushë.
- c) Implementimi i projektit, kërkon njohuri specifike në fushën e BI. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që sistemi do të zbatohet nga personel teknik që ka kaluar kushtet e prodhuesve për specialiste të këtij lloji.
- d) Punonjësi i certifikuar për bazë të dhënash i cili nevojitet për ngritjen, ndërlidhjen dhe mirëmbajtjen e bazës të dhënave, mbi të cilën operon sistemi. Për këtë, OE duhet të disponojë personel me njohuri në këtë fushë.
- e) Punonjësi i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni AL-Billing nevojitet për zhvillimin, përshtajen si dhe përmirësimin e sistemit AL-Billing. Kjo kërkesë bazohet në termat e referencës së projektit ku operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT.
- f) Punonjësi i certifikuar për zhvillim në web/mobile. Kjo kërkesë mbështetet në termat e referencës së shërbimit, ku operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin në

komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT. Sistemi AL-Billing mbështetet në teknologjinë web, ndërsa disa pjesë të rendeshme të sistemit bazohen në programin me teknologji mobile.

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një ofertë teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

- Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);
- Konfirmimin e realizimit të lidhjes për shkëmbimin e pagesave në një nga Bankat.
- Përgjigje një më një të kërkesave teknike të specifikuar në Termat e Referencës të sistemit.

Shënim: Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen.

Argumentim: Projekti kërkohet të realizohet duke u mbështetur në permiresimet dhe zbatimet e shërbimeve të kërkuara në Termat e Referencës së projektit. Në përgjigje të kërkesave të termave të referencës, kërkohet që Ofertuesi të paraqesë zgjidhjen e tij për secilën kërkesë. Këto zgjidhje kërkohet të përcaktohen në formën e përgjigjes për çdo pikë/kërkesë të ToR. Përgjigjet duhet të argumentohen në zgjidhjen specifike të ofertuar, print screen nga sistemi apo referenca në datasheet apo materiale standarde të prodhuesit të sistemit. Nëse përdoren referenca të dokumentacionit standard të prodhuesit, kërkohet që këto referenca të shoqërohen me emrin e dokumentit si dhe faqen në të cilat këto kërkesa trajtohen.

Në ToR të shërbimit, kërkohet që Operatorët Ekonomik të realizojnë një lidhje të shkëmbimit të informacionit të pagesave me bankat. Të dhënat e marra nga bankat (sipas ToR), do të përmbajnë faturën e paguar, klientin si dhe shumën në mënyrë që sistemi i billing të bëjë lidhjen automatike. Operatori ekonomik kërkohet të ketë njohuri në këtë fushë, ndaj lidhja me njërin nga bankat në vend, konsiderohet si i domosdoshëm për suksesin e projektit. Kjo tregon që veç aftësive teknike, operatori është njohës i proceseve si dhe i kërkesave të vecanta që lidhen me sigurinë dhe konfidencialitetin e kësaj informacioni.

Vetëm nëpërmjet një dokumentimi të tillë të zgjidhjes, Autoriteti Kontraktor ka mundësinë e verifikimit të plotë të kërkesave të përcaktuara në ToR. Për këtë, përgjigjet në formën copy-paste nuk lejohen.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike (pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.